VENDIM
Nr. 259, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.928, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRATVE, "PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONIN PËR PENSIONIN SOCIAL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja "a", e pikës 2, të vendimit nr.928, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Shtetasi, që plotëson kriteret për trajtimin financiar me pension social, plotëson kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*", ndërsa dokumentet origjinale dërgohen nëpërmjet shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku kanë vendbanimin.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj